

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Haga unifikon Tiranën, krah Prishtinës deklarata e Kuvendit: Nuk rishkruhet historia e një populli
ADRESA	https://a2news.com/shqiperia/politike/haga-unifikon-tiranen-krah-prishtines-deklarata-e-kuvendit-nu-i1185300
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 17:03:41 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 16:53:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8ebc2352e8f918e4e463c5afa324c3f74cdbba4b1c2cf45d3538426ea0b462b6
TEKSTI	bba41da757426bba8f200344f6d9b0dcac0b524312657f5050eff94cd94b0bc8
PAMJA	157a039fefb975fe08fac6932109b35fb48bbe54d17ae07893f280355902e46b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1e82ac65fa32fe5be05fffdb88c578241acea49003460ad20a1869fc96d23e0b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a0e62f20f1566f1a6ab80e6e4e50c1c4744bc54a84695e6ceb27bc326e386c4d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1e82ac65fa32fe5be05fffdb88c578241acea49003460ad20a1869fc96d23e0b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Haga unifikon Tiranën, krah Prishtinës deklarata e Kuvendit: Nuk rishkruhet historia e një populli



Nga Indrit Maraku
17 Shtator 2026, 18:53 | Politikë



Kuvendi i Shqipërisë shpreh indinjatën e thellë dhe mos dakordësinë e plotë me një vendim që e konsideron thellësisht të padrejtë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Si rrallëherë, politika në Shqipëri foli me një gjuhë të unifikuar, institucionale, pas dënimeve të shprehura nga Dhomat e Specializuara në Hagë kundër ish-komandatëve të UÇK.

"E palëkundur mbetet bindja jonë në pafajësinë e tyre dhe po aq e palëkundur mbetet e vërteta historike: UÇK-ja luftoi për lirinë dhe çlirimin e Kosovës. Një aktgjykim nuk mund të rishkruajë historinë e një populli. Nuk mund të zhbëjë karakterin çlirimtar të luftës së Kosovës apo të barazojë agresorin me viktimën".

Përmes një deklarate të dakordësuar nga të gjitha grupet parlamentare të Kuvendit, Republika e Shqipërisë çoi një mesazh në Beograd dhe Moskë.

"Kuvendi qëndron kundër çdo përpjekjeje të Serbisë dhe Rusisë për ta instrumentalizuar politikisht këtë proces, për të relativizuar krimet e regjimit të Milosheviçit dhe për të delegjitimuar luftën çlirimtare, pavarësinë dhe shtetësinë e Kosovës".

Për qytetarët dhe institucionet e Kosovës, u theksua se nuk është thënë ende fjala e fundit.

"Kuvendi i Shqipërisë qëndron në solidaritet të plotë me Kosovën, popullin dhe institucionet e saj, si dhe pranë Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit dhe familjeve të tyre. Ky aktgjykim nuk është fjala e fundit. Kuvendi pret që të gjitha mjetet juridike dhe shkallët e mëtejshme të procesit të ndiqen deri në fund, duke garantuar respektimin e plotë të standardeve të procesit të rregullt ligjor".

Si përfaqësim i vullnetit të popullit, Kuvendi mori përsipër edhe disa detyra.

"Kuvendi i Shqipërisë angazhohet që: Në të gjitha forumet ndërkombëtare të denoncojë krimet e regjimit serb të Slobodan Milosheviçit në Kosovë, përfshirë aktet gjenocidale, krimet e luftës dhe dhunën seksuale gjatë luftës; të kërkojë drejtësi për viktimat dhe të dënojë mungesën e angazhimit të autoriteteve serbe për zbardhjen e këtyre krimeve, vendosjen e përgjegjësisë dhe garantimin e drejtësisë për viktimat".

Rruga institucionale mbetet e vetmja për korrigjimin e padrejtësisë, në koordinim me Kuvendin e Kosovës dhe dy qeveritë në Tiranë dhe Prishtinë. **(A2 Televizion)**

TE FUNDIT

🕒 "Haga i dha Vuçiçit armën më të fortë", Tromp: Gjykata u krijua për të kënaqur Serbinë, dënimi për Thaçin mizori

Nis Europa League, Milan mundet nga benfica në shtëpi, fiton Bayer Leverkusen

Prej 4 ditësh në arrati dhe në kërkim nga policia greke, Alket Rizai dyshohet se ka ardhur në Shqipëri

🕒 "Është qesharake", Trump kundër Kanadasë: Tarifa më të larta nëse afrohet me BE

MË TË VIZITUARAT

"Sytë" rusë mbi Amerikën 14 satelitë spiunë mbi bazën e SHBA para sulmit ira...

Kategoria Superiore, Vllaznia kërkon fitoren e parë përballë Teutës

Kurti takon kreun e PDK pas dënimit të ish-krerëve të UÇK: Vendimi duhet ndry...

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



Pagat e magistratëve, PD kërkon më shumë konsultime, PS e quan hipokrizi dhe nuk tërhiqet



“Jam kërcënuar, por nuk kam frikë”, Dash Sula: Rama më riktheu dinjitetin



“UÇK lindi si përgjigje ndaj gjenocidit të Millosheviçit”. Kuvendi del me deklaratë pas vendimit të Gjykatës Speciale



KAYO dhe trafiku i armëve, PS refuzon kërkesën e PD për komision hetimor: Nuk ka indicie




Berisha paralajmëron Peleshin: E ke zëvendësin gati



Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Berisha: Vuçiç dhe argati i tij Edi Rama janë përgjegjës direkt për atë që ndodhi në Hagë

Latest Videos



"Padrejetësi e madhe", eksperti: Haga u dha dritë jeshile regjimeve nëpër botë



"Të mblihdhet urgjent qeveria", eksperti: Të ndihmojë ish-luftëtarët, të mos rrezikojmë imazhin

A mund ta zhbëjë Kosova Gjykatën e Hagës? Eksperti: Ja skenarët



"Haga i dha Vuçiçit armën më të fortë!" Trump: u krijua për të kënaqur Serbinë! Mizori dënimi...

Shqipëria

Aktualitet
Kronikë
Politikë
Ekonomi
Sociale
Kulturë
Moti

Kosova

Kulturë
Sociale
Ekonomi
Politikë
Kronikë
Aktualitet

Rajoni & Bota

Balkani
Bota

Argëtim

Showbiz
Lifestyle
Kapur në kamera
Teknologji

Sport

Live Euro 2024
Futboll
Sporte të tjera

Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta
A2 CNN në Izrael
31 Minuta
A2 CNN në Ukrainë
Lumi i kokainës
Ditari ndërkombëtar
Zbulio
Imagjinatë
Dëshmi



A2 CNN LOGO

Live TV

Rreth nesh Kushtet e Privatësisë Karriera Kontakt

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved.

Mundësiuar nga Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.